

MANUAL PRAKTIK

I FUSHAVE KRYESORE TË MARC 21

DHE ZBATIMI I TYRE NË PLATFORMËN KOHA (ILS)

Përgatiti:
SHKENDIJE BERISHA PAJAZITI

MANUAL PRAKTIK I FUSHAVE KRYESORE
TË MARC 21 DHE ZBATIMI I TYRE NË PLATFORMËN
KOHA (ILS)

Kryeredaktore e botimit:
Dr. BLERINA ROGOVA GAXHA

Përgatiti:
SHKENDIJE BERISHA PAJAZITI

Kopertinën:
DARDAN LUTA

Botues:
BIBLIOTEKA KOMBËTARE E KOSOVËS
“PJETËR BOGDANI”

MANUAL PRAKTIK

I FUSHAVE KRYESORE TË MARC 21

DHE ZBATIMI I TYRE NË PLATFORMËN KOHA (ILS)

Përgatiti:
SHKENDIJE BERISHA PAJAZITI

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”
Prishtinë, 2026

PARATHËNIE

Në praktikën bashkëkohore bibliotekare organizimi i saktë i informacionit bibliografik përbën një element thelbësor për qasjen, kërkimin, identifikimin dhe shkëmbimin efikas të të dhënave ndërmjet institucioneve bibliotekare. Në këtë kontekst, standardi MARC 21 përfaqëson një nga formatet më të rëndësishme ndërkombëtare për kodimin, strukturimin dhe shkëmbimin e të dhënave bibliografike, duke mundësuar unifikimin e praktikave të katalogimit dhe ndërveprimin e sistemeve bibliotekare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ky manual shpjegon fushat kryesore të formatit bibliografik MARC 21 dhe zbatimin e tyre në platformën Koha (ILS), duke u mbështetur në shembuj konkretë nga praktika e përditshme e katalogimit. Përmbajtja e tij mbështetet në standardet ndërkombëtare të katalogimit dhe në përvojën time shumëvjeçare profesionale në fushën e katalogimit.

Gjatë hartimit të manualit është përdorur standardi MARC 21, duke u mbështetur në burimin zyrtar, [*Library of Congress – MARC 21 Format for Bibliographic Data*](#), i cili shërben si referencë themelore për strukturën e fushave dhe nënfushave bibliografike. Shembujt dhe procedurat e përshkruara bazohen në zbatimin praktik të këtyre fushave në sistemin e integruar bibliotekar Koha [*Koha Integrated Library System \(ILS\)*](#), i cili mbështet katalogimin sipas standardit MARC 21.

Në këtë manual paraqiten fushat më të përdorura të skemës MARC 21 në platformën Koha, me shembuj konkretë të fushave të përbashkëta për të gjitha llojet e materialeve bibliotekare, me theks të veçantë në koleksionin e librave. Në fund të manualit janë përfshirë edhe fusha më specifike që përdoren për lloje të veçanta materialesh bibliotekare, si periodikët, disertacionet, dorëshkrimet dhe koleksionet e tjera të specializuara. Këto fusha janë paraqitur për qëllime orientuese dhe referuese, me synim për t'u ardhur në ndihmë kataloguesve në trajtimin e materialeve që kërkojnë përshkrim bibliografik më të specializuar.

Manuali përfshin fushat MARC 21 nga 001 deri te fusha 952 dhe shërben si një udhëzues praktik për katalogimin e materialeve bibliotekare në platformën Koha. Çdo fushë është shpjeguar përmes përshkrimit të funksionit të saj, përdorimit të indikatorëve, nënfushave përkatëse dhe shembujve konkretë të zbatimit në praktikë.

Indikatorët në fushat MARC 21 kanë rol të rëndësishëm në interpretimin dhe përpunimin e të dhënave bibliografike, prandaj plotësimi i tyre duhet të bëhet me kujdes dhe në përputhje me rregullat e standardit. Po ashtu, duhet të kihet parasysh se jo të gjitha nënfushat janë të detyrueshme, por përdoren sipas nevojës varësisht nga lloji i materialit dhe informacioni që merret gjatë procesit të katalogimit.

Qëllimi i këtij manuali është të sigurojë përdorim të saktë dhe të standardizuar të fushave MARC 21, duke mundësuar organizim efikas të informacionit bibliografik, kërkim më të lehtë të burimeve dhe menaxhim më cilësor të koleksioneve bibliotekare.

Shpresojmë që ky manual të shërbejë si udhëzues i dobishëm për kataloguesit e rinj dhe, në veçanti, për kataloguesit që do të kyçen për herë të parë në Rrjetin Bibliotekar të Kosovës, i cili përfshin 48 biblioteka. Besojmë se manuali do ta lehtësojë procesin e katalogimit dhe do të kontribuojë në zbatimin sa më të njëtrajtshëm të standardeve bibliografike në të gjitha bibliotekat e rrjetit.

Në këtë parathënie shfrytëzoj rastin t'i shpreh falënderimet e singerta për drejtoreshën e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, Blerina Rugova, për mbështetjen dhe mundësinë që më dha për botimin e këtij manuali.

Shpresoj që ky manual të kontribuojë në ngritjen profesionale të katalogimit bibliotekar, në rritjen e cilësisë së regjistrimeve bibliografike dhe në forcimin e standardizimit të praktikave bibliotekare në përgjithësi.

Shkendije Berisha Pajaziti

MBAJ MEND RREGULLAT KRYESORE!

	STRUKTURA MARC 21	Tag → Indikatorë → Nënfisha.
	INDIKATORËT	Gjithmonë kontrollo indikatorët para se t'i plotësosh nënfushat.
	NËNFUSHAT	Nënfushat shkruhen me shkronjë të vogël (\$a, \$b, \$c) dhe jo çdo nënfushë është e obligueshme.
	020	ISBN – pa hapësira ose karaktere të panevojshme.
	041	Gjuha e dokumentit (p.sh. \$a alb).
	080	KDU (klasifikimi Decimal Universal).
	100	Autori personal kryesor.
	110	Autori korporativ / institucioni.
	111	Konferenca, takimi ose kongresi.
	245	Titulli kryesor – kontrollo indikatorin e dytë.
	246	Titull alternativ / variant.
	250	Botimi (edition).
	260	Vendi, botuesi, viti i botimit.
	300	Përshkrimi fizik (faqe, ilustrime, përmasa).
	500	Shënime të përgjithshme.
	504	Bibliografia, referencat.
	600	Emër personal si term lëndor.
	650	Terma lëndorë (subject headings).
	651	Termet gjeografikë (emër vendi).
	700	Autor personal bashkëpunues.
	710	Autor korporativ bashkëpunues.
	942	Lloji i materialit në Koha.
	952	Ekzemplari (inventari, signatura, lokacioni, statusi).
	KONTROLLO	020, 041, 080 , 100, 110, 111, 245, 260, 300, 500, 504, 600, 650, 651, 700, 710, 942, 952.
	PARA RUAJTJES	Verifiko fushat kryesore dhe kontrollo dublikatat.
	RREGULLI KRYESOR	Katalogo atë që sheh në dokument, jo atë që mendon se duhet të jetë.

**SKEMA E FUSHAVE KRYESORE
TË STANDARDIT MARC 21
DHE ZBATIMI I TYRE
NË PLATFORMËN KOHA**

(me theks të veçantë katalogimi i koleksionit të librave)

000 – LEADER (UDHËHEQËSI - skeleti teknik i rekordit MARC 21)

Për çfarë përdoret?	Fushë fikse me 24 karaktere në fillim të çdo regjistri bibliografik. Ajo i tregon sistemit llojin e materialit, nivelin bibliografik, statusin, gjatësinë e rekordit dhe mënyrën si do të lexohet rekordi.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar. Elementet janë të përcaktuara sipas pozicioneve fikse.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	Nuk ka nënfusha. Ka pozicione 00-23, p.sh. 05 statusi, 06 lloji i rekordit, 07 niveli bibliografik, 17 niveli i kodimit.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

000 01247nam a2200301 i 4500

Kuptimi i shembullit

01247 = gjatësia; n = rekord i ri; a = material tekstual; m = monografi; i = përshkrim ISBD; 4500 = harta e hyrjes.

Ideja kryesore e fushës

Leader është skeleti teknik i rekordit MARC.

Krahasimi me fusha të ngjashme

Krahasuar me 008, Leader është më teknik; 008 jep metadata bibliografike të koduara.

Përmbledhje

Pa Leader rekordi nuk lexohet saktë nga sistemi Koha/MARC.

001 - CONTROL NUMBER (NUMRI I KONTROLLIT)

Për çfarë përdoret?	Identifikon rekordin me një numër unik të caktuar nga institucioni ose sistemi bibliotekar.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	Nuk ka nënfusha.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC/KOHA

001 000000123

003 BIBAL

Kuptimi i shembullit

000000123 është ID-ja e rekordit; BIBAL tregon sistemin që e ka krijuar numrin.

Ideja kryesore e fushës

001 është numri unik i rekordit.

Krahasimi me fusha të ngjashme

001 lidhet drejtpërdrejt me 003, ndërsa 035 ruan numra nga sisteme të tjera.

Përmbledhje

Fusha kryesore e identifikimit teknik.

**003 - CONTROL NUMBER IDENTIFIER
(IDENTIFIKUESI I NUMRIT TË KONTROLLIT)**

Për çfarë përdoret?	Tregon kodin e institucionit që ka krijuar ose caktuar numrin në 001.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	Nuk ka nënfusha.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

001 ocm14919759

003 OCoLC

Kuptimi i shembullit

Numri i kontrollit në 001 vjen nga OCLC.

Ideja kryesore e fushës

003 shpjegon prej nga vjen 001.

Krahasimi me fusha të ngjashme

003 nuk është vetëm numër kontrolli. Ai identifikon burimin e numrit.

Përmbledhje

Përdoret bashkë me 001 për identifikim të saktë.

**005 - DATE AND TIME OF LATEST TRANSACTION
(DATA DHE KOHA E TRANSAKSIONIT TË FUNDIT)**

Për çfarë përdoret?	Regjistron datën dhe orën kur rekordi është përditësuar për herë të fundit.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfishat	Nuk ka nënfusha. Formati është YYYYMMDDHHMMSS.f.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

005 20260510213045.0

Kuptimi i shembullit

Rekordi është ndryshuar më 10 maj 2026, ora 21:30:45.

Ideja kryesore e fushës

005 është vula kohore e rekordit.

Krahasimi me fusha të ngjashme

005 ndryshon sa herë ndryshohet rekordi; 008/00-05 mbetet data e krijimit fillestar.

Përmbledhje

Fushë kontrolli për versionin dhe sinkronizim.

006 - ADDITIONAL MATERIAL CHARACTERISTICS (KARAKTERISTIKA SHITESË TË MATERIALIT)	
Për çfarë përdoret?	Përdoret për karakteristika shitesë të materialit kur një rekord përshkruan më shumë se një formë materiali, p.sh. libër me CD, hartë ose DVD.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet. Mund të ketë disa 006 për materiale të ndryshme shitesë.
Nënfushat	Nuk ka nënfusha. Pozicionet 00-17 varen nga kodi i formës së materialit në 006/00.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

006 j#####

006 e#####

Kuptimi i shembullit

j = regjistrim zanor/CD; e = material hartografik/hartë. Libri ka edhe CD dhe hartë.

Ideja kryesore e fushës

006 tregon çfarë tjetër ka materiali përveç formës kryesore.

Krahasimi me fusha të ngjashme

008 përshkruan materialin kryesor; 006 për materialet shitesë; 007 për formatin fizik.

Përmbledhje

E rëndësishme kur materiali është i kombinuar.

**007 - PHYSICAL DESCRIPTION FIXED FIELD
(FUSHË FIKSE E PËRSHKRIMIT FIZIK)**

Për çfarë përdoret?	Jep të dhëna të koduara për karakteristikat fizike të materialit: tekst, hartë, video, regjistrim zanor, mikroformë, burim elektronik etj.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet, sidomos kur ka forma të ndryshme fizike.
Nënfushat	Nuk ka nënfusha. Pozicioni 00 tregon kategorinë fizike; pozicionet e tjera ndryshojnë sipas kategorisë.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

007 ta

007 sd

007 vd

Kuptimi i shembullit

ta = tekst/libër; sd = regjistrim zanor; vd = video.

Ideja kryesore e fushës

007 tregon si duket fizikisht materiali.

Krahasimi me fusha të ngjashme

007 është e koduar; 300 është përshkrim fizik në tekst të lexueshëm.

Përmbledhje

Përdoret për filtrime dhe përshkrim fizik teknik.

**008 - FIXED-LENGTH DATA ELEMENTS
(ELEMENTE TË TË DHËNAVE ME GJATËSI FIKSE)**

Për çfarë përdoret?	Fusha 008 është një fushë me 40 pozicione fikse (00-39) që përmban të dhëna të koduara për materialin bibliografik. Metadatat e koduara: data e futjes në sistem, viti i botimit, vendi i botimit, gjuha, forma letrare etj.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	Nuk ka nënfusha. Ka pozicione fikse 00-39.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

Libër me përmbajtje shkencore/informuese

245 10 \$a Historia e arsimit në Kosovë

008 240528s2023 kv ||||| |||| 000 0 alb 0

0 → te pozicioni 33 tregon se libri është me përmbajtje të përgjithshme shkencore/informuese *(me gjerësisht shih metadatat e koduara te kjo fushë)*

Vepër letrare

245 10 \$a Netët e qytetit

008 240528s2024 kv ||||| |||| 000 1 alb 1

1 → të pozicioni 33 tregon se materiali është vepër letrare *(me gjerësisht shih metadat e koduara te kjo fushë)*

Përmbledhje e plotë e shembullit (008) (Netët e qytetit - vepër letrare)

008 240528s2024 kv ||||| |||| 000 1 alb 1

240528 → data e regjistrimit në sistem

24 = viti 2024

05 = muaji maj

28 = dita

s → viti i botimit

kv → vendi i botimit (kv = Kosovë)

alb → gjuha (alb = shqip)

1 → vepër letrare

Ideja kryesore e fushës

008 është karta e fshehtë e materialit.

Krahasimi me fusha të ngjashme

008 përshkruan materialin kryesor (është më bibliografike); 006 për materialet shtesë; 007 për formatin fizik.

Përmbledhje

Fushë themelore për kërkim dhe filtrime automatike.

**015 - NATIONAL BIBLIOGRAPHY NUMBER
(NUMRI I BIBLIOGRAFISË KOMBËTARE)**

Për çfarë përdoret?	Përdoret për ta regjistruar numrin identifikues që i është caktuar materialit në një bibliografi kombëtare.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - numri i bibliografisë kombëtare; \$q - sqarim ose informacion shtesë; \$z - numër i pavlefshëm ose i anuluar; \$2 - burimi i numrit.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

015 ##\$a84-3117\$2bnf

Kuptimi i shembullit

84-3117 është numër në bibliografinë kombëtare franceze (bnf).

Ideja kryesore e fushës

015 lidhet me bibliografinë kombëtare.

Krahasimi me fusha të ngjashme

015 nuk është i njëjtë me 016: 015 është numër bibliografie; 016 është numër kontrolli agjencie.

Përmbledhje

Identifikues kombëtar bibliografik.

**016 - NATIONAL BIBLIOGRAPHIC AGENCY CONTROL
NUMBER (NUMRI I KONTROLLIT TË AGJENCISË
BIBLIOGRAFIKE KOMBËTARE)**

Për çfarë përdoret?	Përdoret për ta regjistruar numrin e kontrollit të caktuar nga një agjenci bibliografike kombëtare, përveç Library of Congress. Ky numër shërben për identifikimin unik të regjistrimit bibliografik në agjencinë përkatëse kombëtare.
Indikatori i parë	# - Library and Archives Canada; 7 - burimi jepet në \$2.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - numër kontrolli; \$z - numër i anuluar; \$2 - burimi; \$8 - lidhje.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

016 7#\$aPTBN000004618\$2PoLiBN

Kuptimi i shembullit

Numri vjen nga agjencia e shënuar në \$2.

Ideja kryesore e fushës

Fusha 016 ruan numrin e kontrollit të regjistrimit bibliografik të dhënë nga një agjenci bibliografike kombëtare. Krahasimi me fusha të ngjashme.

Përmbledhje

Fushë për identifikim në sisteme kombëtare.

**020 - INTERNATIONAL STANDARD BOOK NUMBER
(NUMRI STANDARD NDËRKOMBËTAR I LIBRIT) (ISBN)**

Për çfarë përdoret?	Regjistrojnë ISBN-në e librit ose materialit monografik.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet, sepse një libër mund të ketë ISBN për formate të ndryshme.
Nënfushat	\$a - ISBN valid; \$q - informacion kualifikues; \$z - ISBN i pavlefshëm.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

020 ##\$a9789994381853\$qkopertinë e butë

Kuptimi i shembullit

020 ##\$aISBN i librit; \$q tregon se libri ka kopertinë të butë.

Ideja kryesore e fushës

020 = numri standard i librit.

Krahasimi me fusha të ngjashme

020 për libra; 022 për seriale.

Përmbledhje

Fushë shumë e rëndësishme për identifikimin e librave.

040 - CATALOGING SOURCE (BURIMI I KATALOGIMIT)

Për çfarë përdoret?	Tregon agjencinë që krijoi, transkriptoi ose ndryshoi rekordin, gjuhën e katalogimit dhe standardin e përdorur.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - zakonisht nuk përsëritet.
Nënfushat	\$a - agjencia origjinale; \$b - gjuha; \$c - transkriptuesi; \$d - modifikuesi

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

040 ##\$aBKK\$bAlb\$cBKK

Kuptimi i shembullit

BKK e krijoi rekordin; gjuha është shqip

Ideja kryesore e fushës

040 tregon kush e krijoi

Krahasimi me fusha të ngjashme

003 tregon burimin e numrit 001; 040 tregon burimin e katalogimit.

Përmbledhje

Fushë për gjurmimin profesional të katalogimit.

041 - LANGUAGE CODE (KODI I GJUHËS)

Për çfarë përdoret?	Regjistrojnë kodet e gjuhës së materialit, përkthimit dhe gjuhës origjinale.
Indikatori i parë	0 # - materiali nuk është përkthim ose nuk ka informacion; 1 # - materiali është përkthim.
Indikatori i dytë	# - kode standarde MARC21 për gjuhët psh. alb, eng, ita etj
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - gjuha e tekstit; \$b - gjuha e përmbledhjes; \$h - gjuha origjinale

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

041 0#\$aalb\$aeng\$aager

Kuptimi i shembullit

Teksti është në gjuhën shqipe, angleze dhe gjermane.

041 1#\$aeng\$hfre

Kuptimi i shembullit

Teksti është në gjuhën angleze; origjinali ishte në frëngjisht.

Kuptimi i shembullit

041 0# \$aalb \$beng \$bita

Teksti është në gjuhën shqipe, përmbledhja në anglisht dhe italisht.

Ideja kryesore e fushës

041 është kodi teknik i gjuhës.

Krahasimi me fusha të ngjashme

546 jep shënim në tekst; 041 jep kode të strukturuar.

Përmbledhje

Shumë e rëndësishme për përkthime.

080 - UNIVERSAL DECIMAL CLASSIFICATION
(KLASIFIKIMI UNIVERSAL DECIMAL (UDC/KDU))

Për çfarë përdoret?	Përdoret për ta shënuar numrin e klasifikimit KDU/UDC që tregon subjektin ose fushën e njohurive të materialit.
Indikatori i parë	# - nuk ka informacion; 0 - edicion i plotë; 1 - edicion i shkurtuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - numri KDU/UDC; \$b - numri i artikullit; \$x - nënndarje

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

080 ##\$a821.111

Kuptimi i shembullit

821.111 = letërsi angleze

Ideja kryesore e fushës

080 organizon materialin sipas KDU.

Përmbledhje

Fusha kryesore për klasifikimin e materialeve bibliotekare.

100 - MAIN ENTRY - PERSONAL NAME (HYRJA KRYESORE – EMËR PERSONI)	
Për çfarë përdoret?	Hyrja kryesore kur autori përgjegjës është person.
Indikatori i parë	0 - emër i drejtpërdrejtë; 1 – mbiemër (<i>forma më e zakonshme</i>); 3 - emër familjar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	\$a - emri; \$b - numërimi; \$c - tituj; \$d - datat \$q - forma e plotë

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

100 0# \$a Migjeni, \$d 1911-1938 \$q (Millosh Gjergj Nikolla)
700 1# \$a Nikolla, Millosh Gjergj \$d 1911-1938

Kuptimi i shembullit

Autori njihet si “Migjeni”, por emri i tij i plotë është Millosh Gjergj Nikolla.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA (100 1)

100 1#\$aKadare, Ismail, \$d1936-2024

Kuptimi i shembullit

Autori kryesor është Ismail Kadare; data e lindjes është 1936-2024

Ideja kryesore e fushës

100 = kush është autori kryesor.

Krahasimi me fusha të ngjashme

100 për autor kryesor; 700 për autor/person shtesë.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

100 3# \$a Zogaj, \$c familje mbretërore
245 10 \$a Historia e familjes Zogaj

Kuptimi i shembullit

Hyrja kryesore është familja Zogaj; familja trajtohet si familje mbretërore dhe materiali lidhet me historinë e saj.

Përmbledhje

100 0# përdoret kur autori njihet me emër të drejtpërdrejtë, pseudonim ose emër letrar p.sh. Migjeni, Çajupi etj. *(në këtë rast fusha 700 është e detyrueshme)*;

100 1#përdoret për autorë individualë dhe paraqitet në formën e standardizuar "Mbiemër, Emër", ndërsa

100 3# përdoret kur autori është emër familjar ose dinasti, familje mbretërore, fis, etj. *(në këtë rast fusha 700 nuk është e detyrueshme)*.

110 - MAIN ENTRY - CORPORATE NAME
HYRJA KRYESORE – EMËR INSTITUCIONAL (KORPORATIV)

Për çfarë përdoret?	Hyrja kryesore kur përgjegjësia i takon një institucioni ose organizate.
Indikatori i parë	(0 - emër i përmbysur; 1 – juridik-sion. <i>përdoret rrallë në katalogimin e zakonshëm</i>); 2 - emër direkt.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	\$a - institucioni; \$b - njësia; \$c - vendi; \$d - data; \$e - roli

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

0-Emër i përmbysur

110 0# \$a Biblioteka, Kombëtare e Shqipërisë

Kuptimi i shembullit

Autori institucional është Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.

1-Juridiksion

110 1# \$a Kosovë. \$b Ministria e Arsimit

Kuptimi i shembullit

Autori institucional është Ministria e Arsimit e Kosovës.

2-Emër direkt

110 2# \$a Universiteti i Prishtinës

Kuptimi i shembullit

Autori institucional është Universiteti i Prishtinës.

Ideja kryesore e fushës

110 = autor institucional.

Krahasimi me fusha të ngjashme

110 është hyrje kryesore inst. ; 710 është hyrje shtesë institucionale.

Përmbledhje

Përdoret për raporte, dokumente zyrtare dhe botime institucionale.

111 - MAIN ENTRY - MEETING NAME (HYRJA KRYESORE – EMËR I TAKIMIT / KONFERENCËS)

Për çfarë përdoret?	Hyrja kryesore kur materiali lidhet me konferencë, kongres ose takim.
Indikatori i parë	(0 - emër i përmbysur; 1 – juridiksion. <i>përdoret rrallë në katalogimin e zakonshëm</i>); 2 - emër direkt.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	\$a - emri i takimit; \$c - vendi; \$d - data; \$n – numri.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

0-Emër i përmbysur

111 0# \$a Gjuha Shqipe, Konferenca

Kuptimi i shembullit

Autori kryesor është konferenca “Gjuha Shqipe”, e shkruar në formë të përmbysur.

1-Juridiksion

111 1# \$a Kosovë. \$b Konferenca e Arsimit

Kuptimi i shembullit

Autori kryesor është Konferenca e Arsimit e Kosovës.

2-Emër direkt

111 2# \$a Konferenca e Gjuhës Shqipe \$n (3 : \$d 2024 : \$c Prishtinë)

Kuptimi i shembullit

Materiali është nga konferenca e tretë e gjuhës shqipe, mbajtur në Prishtinë në vitin 2024.

Ideja kryesore e fushës

111 Takim / konferencë / kongres si autor kryesor institucional.

Krahasimi me fusha të ngjashme

111 është hyrje kryesore e takimit; 711 është hyrje shtesë e takimit.

Përmbledhje

Përdoret për materiale të takimeve, konferencave, kongreseve

243 - COLLECTIVE UNIFORM TITLE (TITULL UNIFORM KOLEKTIV)

Për çfarë përdoret?	Titull uniform kolektiv për disa vepra të një autori.
Indikatori i parë	0 - nuk shfaqet; 1 – shfaqet si shënim.
Indikatori i dytë	0-9 - karaktere të anashkaluara.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	\$a - titull kolektiv; \$f - data; \$l - gjuha; \$s - versioni.

SEMBOLI NË FORMATIN MARC21/KOHA

Indikatori-0 *(titulli uniform nuk shfaqet në shënim)*

100 1# \$a Kadare, Ismail

243 00 \$a Vepra

Kuptimi i shembullit

Materiali përmban disa vepra të Ismail Kadaresë.

Titulli uniform “Vepra” përdoret vetëm për organizim/katalogim dhe nuk shfaqet si shënim për përdoruesin.

Indikatori – 1 *(titulli uniform shfaqet në shënim)*

100 1# \$a Kadare, Ismail

243 10 \$a Poezi

Kuptimi i shembullit

Materiali përmban një përmbledhje poezish të Ismail Kadaresë.

Titulli uniform “Poezi” mund të shfaqet si shënim për përdoruesin.

Ideja kryesore e fushës

243 = koleksion veprash.

Përmbledhje

Fushë për përmbledhje/koleksione veprash.

245 - TITLE STATEMENT (TITULL KRYESOR)

Për çfarë përdoret?	Përdoret për regjistrimin e titullit kryesor të materialit, nëntitullit dhe deklaratës së përgjegjësisë (autor, redaktor, përkthyes etj.).
Indikatori i parë	0 – përdoret kur nuk ka hyrje kryesore në fushën 100. 1 – përdoret kur ka hyrje kryesore në fushën 100.
Indikatori i dytë	0-9 - numri i karaktereve që anashkalohen në renditje.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	\$a – titulli kryesor; \$b – nëntitulli; \$c – deklarata e përgjegjësisë; \$n – numri i pjesës ose vëllimit; \$p – emri i pjesës ose vëllimit.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

245 - Fushë e titullit kryesor.

Indikatori i parë - 1

245 10\$aGjenerali i ushtrisë së vdekur /\$cIsmail Kadare.

Kuptimi i shembullit

Titulli është Gjenerali i ushtrisë së vdekur; autori është Ismail Kadare.

Ideja kryesore e fushës

245 = çfarë titulli ka materiali.

Krahasimi me fusha të ngjashme

245 është titulli kryesor; 246 është titull variant.

Indikatori i parë - 0

245 00 \$a Historia e qyteteve shqiptare / \$c redaktor Arben Krasniqi
700 1# \$a Krasniqi, Arben, \$d 1975- \$e redaktor

Kuptimi i shembullit

Titulli është Historia e qyteteve shqiptare; redaktor është Arben Krasniqi
245 10\$ a Historia e letërsisë shqiptare. \$ n Vëllimi 2, \$ p Rilindja Kombëtare
/\$ c Sabri Hamiti.

Kuptimi i shembullit

Titulli kryesor i materialit është "Historia e letërsisë shqiptare". Materiali
i përket Vëllimit 2, ndërsa emri i këtij vëllimi është "Rilindja Kombëtare".
Autor i materialit është Sabri Hamiti.

Shpjegimi i nënfushave

\$a = Historia e letërsisë shqiptare (titulli kryesor)

\$n = Vëllimi 2 (numri i pjesës/vëllimit)

\$p = Rilindja Kombëtare (emri i pjesës/vëllimit)

\$c = Sabri Hamiti (deklarata e përgjegjësisë)

Ideja kryesore e fushës

245 mund të përmbajë jo vetëm titullin kryesor, por edhe numrin dhe
emrin e pjesës ose vëllimit të materialit.

Përmbledhje

Fusha 245 përdoret për ta regjistruar titullin kryesor dhe deklaratën e
përgjegjësisë së materialit.

Personat që kanë role të tjera, si redaktorë, përkthyes ose ilustratorë,
regjistrohen në fushën 700.

**246 - VARYING FORM OF TITLE
(FORMË E NDRYSHME E TITULLIT)**

Për çfarë përdoret?	Përdoret për të regjistruar forma alternative ose variante të tjera të titullit në mënyrë që materiali të gjendet më lehtë gjatë kërkimit.
Indikatori i parë	0 – përdoret kur nuk ka hyrje kryesore në fushën 100. 1 – përdoret kur ekziston hyrje kryesore në fushën 100.
Indikatori i dytë	0 - pjesë titulli; 1 - titull paralel; 3 - titull tjetër; 4 - titull kopertine; 8 - titull në shpinë. (Indikatori i dytë (0–8) tregon variantet e titujve të tjerë)
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - titull variant; \$b - pjesë tjetër; \$i - tekst shpjegues; \$n/\$p - pjesë.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

246 11\$aGeneral of the dead army

Kuptimi i shembullit

Variant anglisht i titullit të veprës së Kadaresë.

Ideja kryesore e fushës

Indikatori i dytë përcakton llojin e variantit të titullit që regjistrohet në fushën 246. Këto variante ndihmojnë përdoruesin ta gjejë materialin edhe kur kërkon me një formë tjetër të titullit.

Krahasimi me fusha të ngjashme

245 përmban titullin kryesor të materialit; 246 përmban variante ose forma të tjera të titullit.

245 10 \$a Historia e qyteteve shqiptare : \$b nga antikiteti deri sot = History of Albanian Cities : from antiquity to the present day

246 11 \$a History of Albanian Cities : from antiquity to the present day

Kuptimi i shembullit

Titulli i librit Historia e qyteteve shqiptare është në gjuhën shqipe dhe angleze

Përmbledhje

Fushë praktike për regjistrimin e formave të ndryshme të titullit, si tituj paralelë, tituj alternativë, tituj kopertine dhe tituj shpine/kurriz.

246 11 \$a History of Albanian Cities (11→ titull paralel psh. në gjuhën angleze)

246 13 \$a Qytetet shqiptare (13→ titull tjetër)

246 14 \$a Historia e qyteteve (14→ titull në kopertinë)

246 18 \$a Qytete shqiptare (18 → titull në shpinë/kurriz)

250 - EDITION STATEMENT (SHËNIMI I BOTIMIT)

Për çfarë përdoret?	Përdoret për ta regjistruar informacionin mbi botimin ose edicionin e materialit, si p.sh. botimi i dytë, i rishikuar, i zgjeruar etj.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	NR - nuk përsëritet.
Nënfushat	\$a - deklarata e botimit; \$b - përgjegjësi që lidhet me botimin.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

250 ## \$a Botimi i dytë \$b i rishikuar dhe i zgjeruar.

Kuptimi i shembullit

Materiali është botimi i dytë i rishikuar dhe i zgjeruar.

Rregulli kryesor/i prerë

Në fushën 250 botimi shkruhet ashtu siç është në faqen e titullit të librit, zakonisht:

me fjalë ose në formën origjinale të gjuhës së botimit.

Nuk e ndryshon kataloguesi.

Nuk përkthehet.

250 ## \$a Botimi i dytë → (për shqip)

250 ## \$a 2nd edition → (për anglisht)

250 ## \$a 2. Auflage → (për gjermanisht) etj.

Ideja kryesore

250 tregon botimin ose edicionin e materialit.

Krahasimi me fusha të ngjashme

250 regjistron informacionin për botimin (edicionin), ndërsa 260 regjistron të dhënat e publikimit.

Përmbledhje

Fusha 250 përdoret për të dalluar një botim ose edicion nga një tjetër të së njëjtës vepër.

260 - PUBLICATION, DISTRIBUTION, ETC. (BOTIMI, SHPËRNDARJA ETJ.)	
Për çfarë përdoret?	Përdoret për t'i regjistruar të dhënat e botimit, shpërndarjes ose prodhimit të materialit, si vendi, botuesi dhe data e botimit.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a – vendi i botimit; \$b – emri i botuesit; \$c – data e botimit; \$e – vendi i prodhimit; \$f – emri i prodhuesit; \$g – data e prodhimit

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

260 ##\$aTiranë :\$bOnufri,\$c2022.

Kuptimi i shembullit

Libri është botuar në Tiranë nga Onufri në vitin 2022.

Ideja kryesore e fushës

260 = ku, kush dhe kur e botoi.

Indikatorët për 260 = zakonisht bosh (##)

Rëndësi kanë vetëm nënfushat \$a \$b \$c

260 ## \$a Prishtinë ; Tiranë ; Shkup \$b Botimet Albas \$c 2026

Kuptimi i shembullit

Libri është botuar nga Albas – Prishtinë / Tiranë / Shkup

Rregull i rëndësishëm. Mbaj mend!

\$a → mund të përmbajë më shumë se një vend botimi, vendet ndahen me pikëpresje (;)

\$b → një botues i vetëm (Botimet Albas)

\$c → viti i botimit

Përmbledhje

Fushë bazë për të dhënat e botimit.

300 - PHYSICAL DESCRIPTION (PËRSHKRIMI FIZIK)	
Për çfarë përdoret?	Përshkruan materialin fizik: numri i faqeve, ilustrimet, dimensionet dhe materialet shoqëruese.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - shtrirja; \$b - detaje fizike; \$c - dimensionet; \$e - material shoqërues.

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

300 ##\$a350 f. :\$billustr. ;\$c24 cm +\$e1 CD.

Kuptimi i shembullit

Libri ka 350 faqe, ilustrime, është 24 cm dhe ka CD.

Ideja kryesore e fushës

300 tregon si duket materiali fizikisht

Krahasimi me fusha të ngjashme

300 përmban përshkrimin fizik të materialit në formë tekstuale (faqe, ilustrime, përmasa etj.), ndërsa 007 përmban të njëjtat karakteristika fizike në formë të koduar për përpunim kompjuterik.

Përmbledhje

Fushë bazë për përshkrimin fizik të materialit bibliotekar.

490 - SERIES STATEMENT (TË DHËNA MBI SERINË)	
Për çfarë përdoret?	Përdoret për ta regjistruar emrin e serisë ose koleksionit ku bën pjesë materiali.
Indikatori i parë	0 – seria nuk gjurmohet me hyrje të kontrolluar. 1 – seria gjurmohet përmes fushës 830.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - deklarata e serisë; \$v - numri; \$l - signatura; \$x – ISSN; \$3 - materiali i specifikuar

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

490 1#\$aBiblioteka e Gjuhësisë Shqiptare\$v7

Kuptimi i shembullit

Materiali bën pjesë në serinë Biblioteka e Gjuhësisë Shqiptare dhe është vëllimi 7 i kësaj serie.

490 1#\$aStudime Albanologjike\$v15\$x0563-1234

Kuptimi i shembullit

Materiali i përket serisë Studime Albanologjike, është vëllimi 15 dhe seria identifikohet me ISSN 0563-1234.

490 1#\$3Vëllimi 2\$aBiblioteka e Historisë Shqiptare\$v2

Kuptimi i shembullit

Deklarata e serisë vlen vetëm për Vëllimin 2, i cili bën pjesë në serinë Biblioteka e Historisë Shqiptare.

Ideja kryesore e fushës

490 përdoret për të regjistruar serinë ku bën pjesë materiali, numrin e tij brenda serisë dhe identifikuesit e serisë.

Krahasimi me fusha të ngjashme

- 490 Seria siç shfaqet në material.
830 Forma e kontrolluar/autorizuar e serisë.

Përmbledhje

Fusha 490 përdoret për të lidhur materialin me një seri botimesh dhe për të regjistruar emrin e serisë, numrin e vëllimit dhe ISSN-në.

Mbaj mend!

- \$a = emri i serisë
\$v = numri i vëllimit
\$x = ISSN
\$3 = pjesa e materialit ku zbatohet seria

500 - GENERAL NOTE (SHËNIM I PËRGJITHSHËM)

Për çfarë përdoret?	Përdoret për regjistrimin e shënimeve të përgjithshme që nuk mbulohen nga fusha më specifike të MARC-ut, si p.sh. titulli i origjinalit, parathënie, pasthënie, bibliografi, veçori të veçanta të materialit etj.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - shënimi kryesor; \$3 - materiali i specifikuar; (\$5 - <i>institucioni</i> ; \$6/\$8 – <i>lidhje</i> . Përdoret rrallë në katalogimin e zakonshëm).

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

500 ##\$aParathënie / Rexhep Ismajli : f. 3-5.

Kuptimi i shembullit

Libri përmban një parathënie të shkruar nga Rexhep Ismajli në faqet 3-5.

500 ##\$3Vëllimi 2\$aParathënie / Rexhep Qosja : f. 2-6.

Kuptimi i shembullit

Vetëm vëllimi 2 ka këtë parathënie të shkruar nga Rexhep Qosja në faqet 2-6.

Në *Koha* shumicën e rasteve bibliotekari përdor vetëm:

\$a → për shënime shtesë

\$3 → kur shënimi shtesë vlen vetëm për një vëllim ose pjesë.

Ideja kryesore e fushës

500 = shënime shtesë për përdoruesin.

Krahasimi me fusha të ngjashme

500 plotëson fushat kryesore 245/260/300 me informacion shtesë.

Përmbledhje

Fushë shënimi që pasuron rekordin.

504 - BIBLIOGRAPHY, ETC. NOTE (SHËNIM BIBLIOGRAFIKE, etj.)	
Për çfarë përdoret?	Përdoret për të regjistruar informacion mbi bibliografinë, referencat, burimet e përdorura etj.
Indikatori i parë	# - i papërcaktuar.
Indikatori i dytë	# - i papërcaktuar.
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - shënimi kryesor; \$3 - materiali i specifikuar; (\$5 - institucioni; \$6/\$8 – lidhje. Përdoret rrallë në katalogimin e zakonshëm).

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

504 ##\$a Bibliografi : f. 210-225.

Kuptimi i shembullit

Bibliografia gjendet në faqet 210-225.

\$3 – Materiali i specifikuar

Përdoret kur shënimi bibliografik vlen vetëm për një pjesë të caktuar të materialit, si një vëllim, shtojcë ose pjesë e veçantë.

504 ##\$3Vëllimi III\$aPërfshin bibliografi në fund të vëllimit.

Kuptimi i shembullit

Vetëm Vëllimi III i materialit përmban bibliografi në fund të tij.

Ideja kryesore e fushës

504 = tregon nëse materiali përmban bibliografi, referenca, indeks etj.

Krahasimi me fusha të ngjashme

504 plotëson fushat kryesore 245/260/300 me informacion shtesë.

Përmbledhje

Fushë shënimi që pasuron rekordin.

505 - FORMATTED CONTENTS NOTE (SHËNIM I STRUKTURUAR I PËRMBAJTJES)	
Për çfarë përdoret?	Përdoret për të paraqitur në mënyrë të strukturuar përmbajtjen e materialit (kapitujt, pjesët, artikujt ose vëllimet).
Indikatori i parë	0 - përmbajtje e plotë; 1 – përmbajtje jo e plotë; 2 - përmbajtje e pjesëshme.
Indikatori i dytë	# – përmbajtje bazike (zakonisht si listë kapitujsh ose pjesësh në nënfushën \$a); 0 – përmbajtje e zgjeruar (përmbajtja strukturohet me nënfusha si \$g, \$t, \$r etj.).
A përsëritet?	R - përsëritet.
Nënfushat	\$a - shënimi kryesor; \$3 - Material i specifikuar; (\$5 - <i>institucioni</i> ; \$6/\$8 – <i>lidhje</i> . Përdoret rrallë në katalogimin e zakonshëm).

SHEMBULL NË FORMATIN MARC21/KOHA

Indikatori i parë 0 (përmbajtje e plotë)

Indikatori i dytë # (përmbajtje bazike)

505 0#\$aKapitulli 1. Hyrje -- Kapitulli 2. Fonologjia -- Kapitulli 3. Morfologjia.

Kuptimi i shembullit

Materiali përmban kapitujt Hyrje, Fonologjia dhe Morfologjia, të paraqitur në një shënim të vetëm të përmbajtjes.

505 1# Përmbajtje e plotë dhe përmbajtje bazike

505 1#\$aKapitulli 1. Hyrje -- Kapitulli 2. Fonologjia -- Kapitulli 3. Morfologjia.

Kuptimi i shembullit

Janë regjistruar vetëm disa kapituj të materialit, por jo e gjithë përmbajtja e tij. Prandaj përmbajtja konsiderohet jo e plotë.

505 00 Përmbajtje e plotë dhe e strukturuar

505 00\$aPërmban: \$gVëllimi I:\$tHistoria e gjuhës shqipe -- \$gVëllimi II:\$tFonologjia e shqipes -- \$gVëllimi III:\$tMorfologjia e shqipes.

Kuptimi i shembullit

Janë regjistruar të gjithë vëllimet e veprës. Për këtë arsye përmbajtja konsiderohet e plotë.

505 20 Përmbajtje e pjesshme dhe e strukturuar

505 20\$aPërmban: \$gVëllimi I:\$tHistoria e gjuhës shqipe -- \$gVëllimi II:\$tFonologjia e shqipes.

Kuptimi i shembullit

Janë regjistruar vetëm vëllimet që janë të disponueshme. Për këtë arsye përmbajtja konsiderohet e pjesshme.

\$3 Material i specifikuar

505 20\$aPërmban: \$3Vëllimi II\$gKapitulli 1:\$tFonologjia -- \$gKapitulli 2:\$tMorfologjia.

Kuptimi i shembullit

Përmbajtja e dhënë i referohet vetëm Vëllimit II të materialit; prandaj shënimi është përmbajtje e pjesshme, e paraqitur në formë të strukturuar.

Shpjegimi

505 0# = përmbajtje e plotë e materialit, e paraqitur në formë bazike (zakonisht në nënfushën \$aKapitulli).

505 1# = përmbajtje jo e plotë e materialit, e paraqitur në formë bazike (zakonisht në nënfushën \$aKapitulli).

505 2# = përmbajtje e pjesshme e materialit, e paraqitur në formë bazike (zakonisht në nënfushën \$aKapitulli).

505 00 = përmbajtje e plotë dhe e strukturuar e të gjitha pjesëve, kapitujve ose vëllimeve të materialit.

505 20 = përmbajtje e pjesshme dhe e strukturuar e disa pjesëve ose vëllimeve të materialit.

(Në praktikën e katalogimit përdoren më shpesh vlerat 505 0#, 505 00 dhe 505 20)

Ideja kryesore e fushës

505 = shënime shtesë për përdoruesin.

Krahasimi me fusha të ngjashme

505 plotëson fushat kryesore 245/260/300 me informacion shtesë.

Përmbledhje

Fushë shënimi që pasuron rekordin.

520 - SUMMARY, ETC. (PËRMBLEDHJE ETJ.)

